



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Mbledhja e radhes e Këshillit Bashkiak Muaji KORRIK mbajtur sot me datë 29/07/2025 ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

Në mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Ardina Hasa, Arnilda Dakare, Fatbardh Cekrezi, Greta Lena, Dalip Hazizaj, Edmond Guri, Marsela Ibro, Brunilda Ballolli, Kodhel Cala, Idri Kokla, Kujtim Brahimi,

Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Këshillit z. Enis Zani.

Merr pjese ne mbledhje nen/Kryetari i Bashkise, z.Tajar Bici.

Në zbatim të Nenit 192 të rregullores së Këshillit Bashkiak; "Kryetari i Bashkisë ka të drejtë të ftojë stafin e tij në mbledhjet e Këshillit, për të dhënë shpjegime juridike dhe ligjore për projekt vendimet e paraqitura nga ekzekutivi në mbledhjen e Këshillit"; asistuan në mbledhje disa prej drejtorëve dhe përgjegjesit e drejtorive përkatëse që dorëzuan projekt vendimet dhe relacionet.

E.Zani: Pershendetje ,duke uruar te keni qene mire nisim mbledhjen Kemi 6 pika ne rendin e dites(i lexon) Hedhim ne votim rendin e dites?

***Miratohet rendi ditës me 13 Vota PRO.**

Vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini

Kryetari Këshillit
Enis Zani

Adresa: Sheshi "Kambe Dermysi" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 9 2272 E-mail:bashkiagramsh@gmail.com

Çështja 1

1- Për dhenien e ndihmes ekonomike per muajin Korrik 2025 (Fondi 6%).

Në mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Ardina Hasa, Arnilda Dakare, Fatbardh Cekrezi, Greta Lena, Dalip Hazizaj, Edmond Guri, Marsela Ibro, Brunilda Ballolli, Kodhel Cala, Idri Kokla, Kujtim Brahimi.

Pergj.Ndh,Ek.:Pershendetje te nderuar.

(Vjen ne mbledhje Keshilltari R.Braho)

***Në mbledhje marrin pjesë 14 këshilltarë**

Per muajin Korrik jane gjeneruar 37 familje per te perfituar nga fondi 6%, sistemi i ndihmes ekonomike. Nese keni ndonje pyetje?

E.Zani: Keni pyetje? Votojme?

***Miratohet pika 1 e rendit te ditës me 14 Vota PRO**

Nuk Ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini

Kryetari Këshillit
Enis Zani

Adresa: Sheshi "Kamber Dermyshe" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail:bashktagramsh@gmail.com

Arnilda Dakare

Dalip Hazizaj

Çështja 2

- 1- Për dhënie e ndihmës financiare të shtetasit Ahmet Kokonozi për shkak të rënies së zjarrit më datë 23.06.2025, lagjia "Xhile Lici", bashkia Gramsh.

Në mbledhje marrin pjesë 14 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Ardina Hasa, Arnilda Dakare, Fatbardh Cekrezi, Greta Lena, Dalip Hazizaj, Edmond Guri, Marsela Ibro, Brunilda Ballolli, Kodhel Cala, Idri Kokla, Kujtim Brahimi, Ramazan Braho.

Dr.emergj.Civ.: Kemi të bëjmë me rastin e rënies së zjarrit në banesën e shtetasit A.Kokonozit, lagjia Xhile Lici shkak i bombules së gazit. Ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm. U ngrit komisioni nga bashkia i cili verifikoi dëmet në banesë.

F.Cekrezi : Akti i ekspertimit është i domosdoshëm bashkëngjitur materialeve.

L.Dollani : Jemi të qartë, dosja është e plotë.

E.Zani : Pyetje?

A.Hasa: Behen shumë njoftime për mbledhje të komisioneve dhe nuk ka asnjë reagim, kjo duhet parë, le të ndryshojnë anetret .

D.Hazizaj: Cila është shuma që do ti jepet?

Dr.emergj.Civ: Vlera është 374.376 leke (vlera reale)

(Vjen në mbledhje Këshilltari A.Bici dhe V.Bici)

**Në mbledhje marrin pjesë 16 këshilltarë*

E.Zani: Votojme?

Miratohet pika 2 e rendit të ditës me 16 Vota PRO.

Nuk ka Vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini

Kryetari Këshillit
Enis Zani

Adresa: Sheshi "Kamber Dermyshe" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail:bashkiagramsh@gmail.com

Arnilda Dakare

Dalip Hazizaj

Çështja 3

- 2- Për disa ndryshime në Vendimin nr.96 datë 30.12.2019 "Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre si dhe penaltetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative".

Në mbledhje marrin pjesë 16 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Ardina Hasa, Arnilda Dakare, Fatbardh Cekrezi, Greta Lena, Dalip Hazizaj, Edmond Guri, Marsela Ibro, Brunilda Ballolli, Kodhel Cala, Idri Kokla, Kujtim Brahimi, Ramazan Braho, Alketa Bici, Visarion Bici.

Dr. Taksave: Kemi menduar të bëjme disa ndryshime të tarifave të parkimit, duhet të blihet mekanizmi (trau elektrik). Parkimi ka 38 vende.

L. Dollani: Ne si grup i këshilltarëve të PS jemi dakort me vendosjen e tarifave por kemi edhe një propozim për parkimet që zgjasin me muaj apo vjetore. Konkretisht për 1 muaj-10000 leke, 6 muaj- 50000 dhe 1 vit-80000 leke.

E. Zani: Jeni dakort bashkë me ndryshimet e sjella? Edhe me propozimin e Grupit të PS?

***Miratohet se bashku me ndryshimet dhe propozimet e këshilltarëve
(Vazhdon diskutimi)**

E. Guri: Infrastruktura sa i përket sinjalistikës është e pershtatshme? Duhet edhe tabelat (neni 8 i K. Rugor). Për propozimin e grupit të PS duhet të bëni klasifikimin e mjeteve.

Dr. Taksave: Edhe ndryshimet në buxhet, për këtë është, për vendosjen e mekanizmit, që të jete aplikimi elektroniqisht të mos ketë abuzime.

T. Bici: Këtu bëhet fjale për parkimi përballë konviktit por termi zyrtar është "parkim public në rrugën Hamit Dollani"

E. Zani: Ndryshimet duhen pasqyruar në vendim, votojmë?

***Miratohet pika 3 e rendit të ditës me 16 Vota PRO**

(Se bashku me ndryshimet dhe propozimet e këshilltarëve)

Nuk ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

(Vazhdon diskutimi)

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini



Kryetari Këshillit
Enis Zani

Adresa: Sheshi "Kamber Dermishi" Bulevardi "10 Korriq" Tel: Fax: 0513 2 2272 E-mail: bashkiagramsh@gmail.com

Arnilda Dakare

Dalip Hazizaj

Çështja 4

4- Për miratimin e disa ndryshimeve në VKB nr.88 datë 27.12.2024 "Për miratimin e programit buxhetor për vitin 2025".

Në mbledhje marrin pjesë 16 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Ardina Hasa, Arnilda Dakare, Fatbardh Cekrezi, Greta Lena, Dalip Hazizaj, Edmond Guri, Marsela Ibro, Brunilda Ballolli, Kodhel Cala, Idri Kokla, Kujtim Brahimi, Ramazan Braho, Alketa Bici, Visarion Bici.

Dr.Finances: Gjate hartimit te buxhetit 2025ne listen e projekteve te miratuara nder te tjera ishin 3 projekte : 1- Rikonstruksion i rruges Dushku ne lagjen Kocaj,2- Rikonstruksion I asfaltimit ne lagjen Kocaj dhe 3- Rikonstruksion I asfaltimit ne fshatin Trashovic. Nisur nga kerkesat e qytetareve u be rishikim i preventivit te punimeve ne zerat per kuneta, tortuare ,ndricim dhe shtresa nenasfaltike. Nisur nga kjo dhe perlllogaritjet ndryshon vlera e investimeve per projektet e lartepermendura (ne nje periudhe financimi prej 3 vitesh).

Citon ndryshimin e vleres fillestare dhe perfundimtare sipas tabelës ne relacion.

Per te mundesuar financimin e shteses se vleres se projekteve te parashikohet ketyre investimeve per vitin 2025 ne vleren 1.500.000 leke nisur nga informacioni e Drejtorise te ardhurave te taksave dhe rakordimet me Shoqerine e Ujesjelles Kanalizime Elbasan do nje shtese ne nivelin e te ardhurave nga tarifat familjare te pastrim gjelberimit, konkretisht detyrimet e prapambetura nga 2024 nga Shoqeria e Ujesjelles Kanalizime Elbasan qe i detyrohet bashkise.

E.Guri: Cdo muaj po na vijne ndryshime te vendimeve qene vet I marrim. Para disa muajsh kemi bere nje calendar dhe degjesat nuk u kryen. Shoh qe rritja e buxhetit vjen nga te ardhurat e atyre qe jane debitore, ku bashkia detyrohet ti paguaje permbarimin per te marre leket tona. Une propozoj qe ne unanimisht te marrim vendim qe kompetencat ten a rikthehen ne,, ta anullojme vendimin ku te ardhurat i vjel dr.Elbasanit dhe ne te lutemi te na i sjelli ne.

F.Cekrezi: Po te shohesh vleren e 3 investimeve, vlera totale e kalon 1 miliard leke shtrire per 3 vjet investim.Drejtoria a ben parashikim per investime te medhaja?. Sa I perket tarifave te reja nga Enti Rregullator I Ujit, sa eshte parashikuar te ndikojte ne rritja e cmimit?

T.Bici: Per sherbimet qe kryen ujesjellesi merr 2 % te vleres totale. Kur kemi miratuar buxhetin ne dhjetor nuk kishim projekte per objektet qe do te financonim, mbasi u bene projektet (8 ne total), ne 3 prej tyre nga azhurnimi qe u be ne terren u kerkua te rishikohej preventivi.

V.Bici: Te gjithë bashke ne mund ta zgjidhim problemin e ujit, mund tja adresojme edhe kryeministrit pot e behemi te gjithë bashke gjejmë zgjidhje .

F.Cekrezi: Bashkia te coje nje shkrese ku ti kerkoje Dr.Rajonale Elbasan metodologjine per vendosjen e tarifave per familje.

E.Zani: Eshte e disata here qe vijme me ndryshime ne buxhet, ju lutem pak me shume seriozitet. Votojme?

***Miratohet pika 4 e rendit te ditës me 16 Vota PRO**

Nuk Ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini

Kryetari Këshillit
Enis Zani

Adresa: Sheshi "Kamber Dermishi" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513-2 2272 E-mail:bashkiagramsh@gmail.com

Çështja 5

5- Për miratimin e Raportit të Komisionit të Dhënies së medaljeve dhe të Titujve vendor të nderit.

Në mbledhje marrin pjesë 16 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Ardina Hasa, Arnilda Dakare, Fatbardh Cekrezi, Greta Lena, Dalip Hazizaj, Edmond Guri, Marsela Ibro, Brunilda Ballolli, Kodhel Cala, Idri Kokla, Kujtim Brahimi, Ramazan Braho, Alketa Bici, Visarion Bici.

L.Dollani: Raportin e keni në dispozicion. Komisioni u rimblodh, dosja është e plote. Është bërë edhe komunikimi në komunitet për vendosjen e bustit të Xhemal Musabelli, të cilët janë dakort. (lexoni raportin)

Njekohesisht na ka ardhur një kërkesë për emërtimin e Qendres Shëndetsore në NjA Skenderbegas me emrin Baftjar Hoxha, duhet të ndjekim praktiken e mëparshme.

F.Cekrezi: Për pikën 2 jepet pelqim në parim nuk merret vendim.

K.Brahimi : Për vendosjen e bustit une jam kundër.

F.Cekrezi: Ja leme një grupi historianesh ta vlerësojnë figurën dhe e shtyjme për moment tjetër.

B.Ballolli: Ne kemi mundësi të një Deshmori tone në listë, dhe ndodhemi përballë një situatë të tillë.

T.Bici: Jemi në dijeni të kësaj situatë e cila do të zgjidhet shumë shpejt.

E.Zani: Jeni dakort të shtyhet kjo pikë?

***Unanimisht Këshilltarët vendosin shtyrjen e kësaj pike, në pritje të mendimit të një grupi historianesh, për të marrë një vendim të drejtë konform ligjit.**

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini



Kryetari Këshillit
Enis Zani

Adresa: Sheshi "Kamber Dermishi" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail:bashkiagramsh@gmail.com

Arnilda Dakare

Dalip Hazizaj

Çështja 6


6 - Për diskutimin e analizës së të dhënave të barometrit 2024 për barazine gjinore.

Në mbledhje marrin pjesë 16 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Ardina Hasa, Arnilda Dakare, Fatbardh Cekrezi, Greta Lena, Dalip Hazizaj, Edmond Guri, Marsela Ibro, Brunilda Ballolli, Kodhel Cala, Idri Kokla, Kujtim Brahimi, Ramazan Braho, Alketa Bici, Visarion Bici.

E.Zani: Kemi një informacion lidhur me një përmbledhje të të dhënave të pyetësorit nga bashkia dhe keshilli në kuader të barometrit në nivel vendor. Vihet re në përgjithësi jo vetëm në bashkine të një respektimi të përcaktimit të ligjit për barazine gjinore (konkretisht dominon gjinia mashkullore).

Merr pjesë Koordinatori i Bashkive të Forta i cili raporton lidhur me informacionin)

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini



Kryetari Këshillit
Enis Zani



Adresa: Sheshi "Kamber Dermishi" Bulevardi "10 Koriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail:bashkiagramsh@gmail.com

Arnilda Sokore

Dalip Hazizaj



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Gramsh, më /07/2025

LISTË PREZENCË E KËSHILLTARËVE BASHKIAK
Mbledhja e Rradhes e Këshillit Bashkiak për Muajin KORRIK 2025

EMER MBIEMER	KORRIK 2025	EMER MBIEMER	FIRMA
1- ENIS ZANI	Enis Zani	29.07.2025	
2- VALBONA VERUSHI			
3- LULJETA DOLLANI	Luljeta Dollani	29.07.2025	
4- KODHEL CALA	29.07.2025		
5- GRETA LENA	29.07.2025	Greta Lena	
6- VISARION BICI	29.07.2025	Visarion Bici	
7- ARDIANA HASA	Ardiana Hasa	29/07/2025	
8- ALKETA BICI	Alketa Bici	29.07.2025	
9- RAMAZAN BRAHO	Ramazan Braho	29.07.2025	
10- EDMOND GURI	EDMOND GURI	29/07/2025	
11- ERALD ÇARÇIU			
12- IDRI KOKLA	Idri Kokla	29.07.2025	
13- ERISA ZOGU			
14- KUJTIM BRAHIMI	Kujtim Brahimi	29/07/2025	
15- MARSELA IBRO	Marsela Ibro	29.07.2025	
16- ALFRIDA SHAHINI			
17- DALIP HAZIZAJ	Dalip Hazizaj	29.07.2025	
18- ARNILDA DAKARE	Arnilda Dakare	29.07.2025	
19- BRUNILDA BALLOLLI	Brunilda Ballolli	29.07.2025	
20- FATBARDH ÇEKREZI	29.07.2025	Fatbardh Çekrezi	
21- BRUNILDA GJEVORI			

SEKRETARI I KËSHILLIT
XHULIA GJINI